



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Mars 2021

Nr: 170

VENDIM

PËR CAKTIMIN E KOHËS SË TRANSMETIMIT NË RADIOTELEVIZIONIN PUBLIK TË FUSHATËS ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ë” e “n”, e 2, dhe 80, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

VËREJ:

Neni 80, pika 1, i ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si subjekte zgjedhore për të bërë fushatë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 80 shkronja “b” dhe “c” të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare.

Partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta në Televizionin Publik dhe jo më pak se 15 minuta në Radion Publike. Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike.



Bazuar në nenin 80, pika 1, të sipërcituar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përllogaritur kohën në dispozicion të subjekteve zgjedhore, duke u bazuar në regjistrimin e tyre për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ku janë regjistruar në total 2 koalicione zgjedhore, 10 parti politike dhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.

Me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2017 për Kuvendin e Shqipërisë, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvendin, rezulton se:

- Partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, janë:
 1. Partia Socialiste e Shqipërisë
 2. Partia Demokratike
- Partitë e tjera parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, janë:
 1. Lëvizja Socialiste për Integrim
 2. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
 3. Partia Socialdemokrate
 4. Partia Fryma e Re Demokratike
 5. Partia Republikane Shqiptare
 6. Partia Kristian Demokrate

Duke analizuar nenin 80 pika 1, shkronja “b”, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit bazuar në parimin e proporcionalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet nga numri i subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar listat shumememorë për kandidatët për deputetë. Neni 65 pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Gjithashtu, si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe parti politike joparlamentare që konkurrojnë më vete apo si parti pjesëtare në koalicione, si edhe 5 kandidat të propozuar nga zgjedhësit të cilët sipas

praktikës së krijuar nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, dhe radiotelevizioni publik, duhet të përfitojnë 5 (pesë) minuta në Televizion dhe 5 (pesë) minuta në Radion Publike.

PËR KËTO ARSYE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenet 19, pikat 1, shkronjat “ë” e “n”, e 2, dhe 80, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S:

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 90 (nëntëdhjetë) minutash, përkatësisht 60 (gjashtëdhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 30 (tridhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore si më poshtë:
 - a) Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”,
 - b) Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 45 (dyzetë e pesë) minuta përkatësisht 30 (tridhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare si më poshtë:
 - a) Partia Socialdemokrate,
 - b) Lëvizja Socialiste për Integrim.

3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 20 (njëzetë) minuta përkatësisht 10 (dhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive joparlamentare dhe koalicionit, si më poshtë:
 - a) Partia Lëvizja për Ndryshim,
 - b) Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare,
 - c) Partia Bindja Demokratike,
 - ç) Partia Balli Kombëtar,
 - d) Partia Lëvizja e Re,



- dh) Partia Aleanca Demokracia e Re,
- e) Partia Nisma Thurje,
- ë) Koalicioni “ABEOK”.

4. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minuta përkatësisht 5 (pesë) minuta në Televizioni Publik dhe 5 (pesë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për secilin prej 5 (pesë) kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit,

- a) Elton Lahim Debreshi,
- b) Kreshnik Luan Merxhani,
- c) Iljaz Jashar Shehu,
- ç) Bojken Xhelal Abazi,
- d) Pal Marash Shkambi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

